




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot. Br Prot. Prot No	06-1515/20
Data Datum Date	17-07-2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-1185/20, për zyrtarin e lartë z. Muhamet Ymeri, Anëtar i Këshillit Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia) ka shqyrtuar rastin për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPKI-06-1185/20, lidhur me zyrtarin e lartë z. Muhamet Ymeri, Anëtar i Këshillit Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Muhamet Ymeri, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Anëtar i Këshillit Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, i njëjti ishte Përfaqësues i Autorizuar në bizneset private "T.SH. Ferizi Company" O.P. dhe "Galanteria Group" SH.P.K. Përmes shkresës zyrtare nr. DPKI-06-516/20, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtutjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me bizneset e cituara mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-01/516/20), rezultonte se zyrtari i lartë z. Muhamet Ymeri është pronar dhe përfaqësues i autorizuar në biznesin në fjalë.



Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Agjencia përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-1185/20 e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Muhamet Ymeri për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese, pala ka kontaktuar zyrtarin përgjegjës të Agjencisë i cili e ka njoftuar palën gjerësisht lidhur me rastin në fjalë, duke i sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë edhe Përfaqësues i Autorizuar në biznes, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Muhamet Ymeri është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndër marr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresat zyrtare DPKI-06-1452/20 dhe DPKI-06-1453/20, me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Muhamet Ymeri ka bërë ndryshimet e kërkuara dhe i njëjti nuk figuron më të jetë Përfaqësues i Autorizuar në bizneset “T.SH. Ferizi Company” O.P. dhe “Galanteria Group” SH.P.K.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Muhamet Ymeri, Anëtar i Këshillit Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

